



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-051

Prishtinë, më 22 janar 2016, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 JANAR 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Myfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Në fillim të mbledhjes, kryetari u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve në punimet e Kryesisë së Kuvendit dhe organeve të tjera të Kuvendit në Sesionin pranveror.

Kryetari, para se të procedojë me rendin e ditës së mbledhjes, në emrin e tij dhe të Kryesisë së Kuvendit shprehu falënderimin për Parlamentin Evropian me rastin e miratimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, më 21 janar 2016.

Ai tha se kjo është një fitore e rëndësishme politike për Republikën e Kosovës, është përkrahje e fuqishme, si dhe shprehje e besimit evropian për kapacitetet tona si institucione dhe si popull i Kosovës për arritjen e aspiratave tona për të qenë pjesë e familjes së madhe evropiane.

Më pas, kryetari propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë: 1. Propozimi për shënimin e 5 Shtatorit - Ditës së Bamirësisë “Nëna Terezë”.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 8 dhjetor 2015 dhe më 14 dhjetor 2015, në orën 9:00 dhe në orën 11:00,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 8 dhjetor 2015 dhe më 14 dhjetor 2015, në orën 9:00 dhe në orën 11:00

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 8 dhjetor 2015, si dhe më 14 dhjetor 2015, në orën 9:00 dhe në orën 11:00.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i Kuvendit lidhur me përgatitjet për seancë plenare i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se nuk mund të vendosim sot në këtë mbledhje për caktimin e saj, ngase deri në fillim të muajit shkurt një numër i deputetëve të Kuvendit gjenden në udhëtime zyrtare jashtë vendit.

Lidhur me përgatitjet për seancë plenare, Kryesia konstatoi se duhet të mbahet edhe një mbledhje tjetër për ta caktuar seancën plenare të radhës.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me programin e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016 t'u shpërndalet të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor për sigurimin e dokumentacionit lidhur me demarkacionin me Malin e Zi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Udhëzohet Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor që të veprojë në pajtim me nenin 65.5 të Rregullores së Kuvendit lidhur me shqyrtimin e shkresave dhe të dokumentacionit që ka të bëjë me demarkacionin me Malin e Zi.

3. Kërkesa për emërimin e kryetarëve dhe nënkryetarëve të Grupeve të Miqësisë

Kryesia e shtyu pikën e lartshënuar për vendimmarrje për mbledhjen e radhës së Kryesisë së Kuvendit.

4. Kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme për emërimin e një anëtari nga radha e GP të LS-së

Kryesia, pas diskutimit lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përbërja e Komisionit për Punë të Jashtme është bërë sipas marrëveshjes së grupeve parlamentare, në rastin konkret ndërmjet Grupit Parlamentar të PDK-së dhe Grupit Parlamentar të Listës serbe.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel prej 26-29 janar 2016

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

përbërje: Teuta Sahatqija, Valdete Bajrami, Luljeta Veselaj-Gutaj, Arben Gashi, Ilir Deda, Time Kadrijaj dhe Kujtim Paçaku, në Bruksel prej 26-29 janar 2016, ndërsa për nënkryetarin e Kuvendit, z. Slobodan Petroviq, prej 26-27 janar 2016.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e kësaj vizite, si dhe shpenzimet me tejkalim të mundshëm, për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Kërkesa e kryetarit të GP të PDK-së, z. Adem Grabovci, për sigurimin e një hapësire për ndërtimin e qendrës për takimet Lutjet e Mëngjesit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Kryesia e Kuvendit mbështet nismën e grupit të deputetëve për ndërtimin e qendrës për takimet Lutjet e Mëngjesit.

2. Kërkohet nga kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti, që të sigurojë një hapësire (lokacion) të përshtatshëm në Prishtinë për ndërtimin e qendrës për takimet Lutjet e Mëngjesit.

7. Kërkesa e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për sigurimin e buxhetit për angazhimin e ekspertëve për studim rasti lidhur me përvojat ndërkombëtare në rastet e ngjashme me ndërmarrjen “Trepça”

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Miratohet kërkesa e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për sigurimin e buxhetit për angazhimin e ekspertëve për studime rasti lidhur me përvojat ndërkombëtare në rastet e ngjashme me ndërmarrjen “Trepça”, në shumë prej pesëmbëdhjetë mijë euro (15, 000), ndërsa shuma tjetër prej pesëmbëdhjetë mijë euro (15, 000) do të mbulohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

8. Kërkesa e nënkryetares së Kuvendit, znj. Duda Balje, për lejimin e udhëtimit në Zvicër prej 5-8 shkurt 2016

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi i nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Duda Balje, në Zvicër, prej 5-8 shkurt 2016.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarën në pikën 1. (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9. Njoftimi i dy (2) nënkryetarëve të Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Itali

Kryesia u njoftua me raportin e nënkryetarëve të Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe z. Slobodan Petroviq, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Itali, prej 26-28 nëntor 2015.

10. Njoftimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Sarajevë, prej 23-24 nëntor 2015

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Sarajevë, prej 23-24 nëntor 2015.

11. Njoftimi i Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, më 9 dhjetor 2015

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, më 9 dhjetor 2015.

12. Njoftimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Beograd, prej 26-27 nëntor 2015

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Beograd, prej 26-27 nëntor 2015.

13. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, prej 17-18 dhjetor 2015

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, prej 17-18 dhjetor 2015.

14. Njoftimi i GP të AAK-së për tërheqjen e deputetit Lahi Brahimaj nga përbërja e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Grupi Parlamentar i AAK-së e ka njoftuar me shkrim Kryesinë e Kuvendit për tërheqjen e deputetit Lahi Brahimaj nga përbërja e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, por ai tha se ky grup parlamentar nuk ka propozuar asnjë deputet tjetër për anëtar të këtij komisioni.

Pika shitesë:

1. Propozimi për shënimin e 5 Shtatorit - Ditës së Bamirësisë “Nëna Terezë”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Ngarkohet Komisioni për Punë të Jashtme që ta përgatisë propozim-vendimin për shpalljen e 5 Shtatorit - Ditës së Bamirësisë “Nëna Terezë” dhe t’ia paraqesë Kuvendit për miratim.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 13:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale